

---

## KRONIKA SHKENCORE

---

### FESTIVALI I FOLKLORIT «I KËNDOJMË LIRISË», IX, KLINË, 2009

Klina edhe sivjet organizoi festivalin e folklorit «I këndojmë lirisë», i nënti me radhë, që mbahet me rastin e ditëlindjes së komandantit Mujë Krasniqi, dëshmor i kombit. Festivali u mbajt më 6-8 qershor. Hapjes së pjesës garuese të festivalit i parapriu përrurimi i kullës së këtij komandanti të njohur të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. E veçantë ishte edhe fjala përshëndetëse e kryetarit të Klinës, bashkëluftëtar i Mujës, z. Sokol Bashota, para të pranishëmve, me rastin e fillimit të festivalit.

Në Klinë, në këtë qendër tashmë të njohur të Rrafshit të Dukagjinit, gjatë tri netëve të festivalit të folklorit «I këndojmë lirisë», u paraqitën para publikut artistë popullorë nga shumë vise të atdheut. Juria profesionale e festivalit, në përbërje: Sejmen Gjokoli, Rexhep Munishi, Zymer Neziri, Deli Metaliaj dhe Rahmi Imeri, ndau këto çmime:

Çmimin «Mujë Krasniqi» e fitoi SHKA «Dervish Shaqa» Deçan. Vendi i dytë i takoi grupit folklorik «Salih e Feriz Krasniqi» Malishevë, kurse vendin e tretë e zuri grupi polifonik «Ylberi» Vlorë. Grupi më i kompletuar u shpall ansambli folklorik «Gurra» Gjilan. Çmimet e tjera të jurisë qenë: Teksti më i mirë-«Klinë, oj motër», Lezhë; Çmimi i publikut- rapsodi Osman Sefë Gashi; Veshja më autentike- «Burimet e Sharrit», Tetovë; Çmimi i veçantë- grupi folklorik «Shpëtimi», Medvegjë; Dueti më i mirë- Hafir e Xhavit Plaqiqi, «Shotë Galica», Drenas; Vallja më e mirë dyshe- «Sharri», Hani i Elezit; Veterani i festivalit- Muharrem Bakalli, Tiranë.

**Zymer Neziri**  
Prishtinë